



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria Për Bujqësi, Pylltari
Dhe Zhvillim Rural

08 Nr. _____ /2021

Dt. ____ / ____ /2021

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahja e fermerëve me mekanizëm bujqësor



Deçan/Maj/2021

Komuna e Deçanit/Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, fton të gjithë fermerët e Komunës së Deçanit që të aplikojnë për garante të vogla në mekanizëm bujqësor.

• **Sektorët të cilët do të përkrahen përmes këtij projekti janë:**

1. Blegtoria;
2. Bletaria;
3. Perimtaria;
4. Pemëtaria;
5. Lavërtaria

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e grantit janë:

- Të jenë banor të Komunës së Deçanit;
- Të jetë fermer i regjistruar NIF(bëjnë përjashtim vetëm fermerët që nuk aplikojnë për subvencione qeveritare);
- Të jetë i,e gatshëm të nënshkruaj kontratë me kushtet e Komunës;
- Të posedojnë tokë bujqësore në pronësi apo të marrë me qira;
- Të jetë i gatshëm të financoj 20% të vlerës së pajisjes.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Aplikacioni merret në zyrat e Drejtorisë së Bujqësisë;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi pronësi të tokës bujqësore, apo të marrë me qira.

1.Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Makinës Mjelëse:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të posedojë lopë qumështore(2-3lopë);
- Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së

2.Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Koshereve për Bletë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kriteret specifike:

- Të ketë së paku 2 koshere;
- Të ketë vërtetimin e deklarimit të numrit të bletëve dhe lokacionin e lëshuar nga DBPZHR

3.Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Motokultivatorit:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer, kultivues i kulturave vreshtarë, perimore, pemëtarë dhe lavërtar;
- Të ketë dëshmi mbi pronësi të tokës bujqësore 0.50ha dhe të ketë të mbjellë së paku 0.50ha me perime apo vreshta.

5.Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Spërkatëse/400L të bimëve:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë kulturat: Lavërtari, Perimkulturë;
- Të ketë tokë të punueshme bujqësore mbi 5 ha(të ketë aplikuar për subvencione qeveritare në vitin paraprak për sipërfaqen mbi 5ha)

6.Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Gërshërëve elektrike(me bateri) për pemëtarët:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë kulturat: Pemë frutore;
- Të ketë pemishte frutore 0.50ha dhe të ketë 0.50ha sipërfaqe në pronësi

Vërejtje:

- Përqindja e përkrahjes nga Komuna e Deçanit do të jetë 80% dhe 20% nga fermeri.
- Pasi të shpallen përfituesit, të gjithë fermerët janë të obliguar që ta kryejnë participimin prej 20% dhe ta nënshkruajnë kontratën me Komunën e Deçanit.
- Për specifikat e pajisjes fermerët do të informohen gjatë procesit të aplikimit.
- Fermeri aplikues ka të drejtë të aplikoj vetëm për një mekanizëm bujqësorë.

Afati për aplikim fillon nga data: **11/05/2021** deri me **31/05/2021**.

Aplikacionet plotësohen në katin e dytë në zyrën nr:**31** dhe dorëzohen për pranim në Drejtorinë e BPZHR-së në katin e tretë zyra nr:**34** në objektin Komunes së Deçanit.